



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA
DREJTORIA E MENAXHIMIT, PROJEKTEVE DHE MONITORIMIT

Lënda: Analizë e realizimit të detyrave për vitin 2018

KËTU

Në zbatim të Programit të punës për vitin 2018, Programit Strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm 2015 - 2020, Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura, si dhe Planit të detajuar të punës për zonat e mbrojtura, kryer nga sektori i menaxhimit gjatw periudhws Janar – Dhjetor 2018 ju informojmë sa mw poshtw:

Sektori i menaxhimit gjatë vitit 2018 u përball me sfida dhe probleme të shumta, njw pjesw e tw cilave ishin tw mbartura nga vitet e mw parshwm si;

- Kontratat e lidhura me ish- DRSHP-të, pwr dhwnie nw pwrdorim tw sipwrfaqes zonw e mbrojtur me kontratw qiraje, pwr veprimtari tw lejuara, baza ligjore e lejueshmërisë, likuidimi financiar i tyre etj.

- Shqyrtimi i kwrkesave tw subjekteve, verifikimi i tyre nw terren nga stafet e AdZM-ve respektive, pwr tw gjitha llojet e veprimeve tw kwrkuara, veçanwrisht pwr veprimtaritw ekonomike qw sjellin impakt nw mjedis (si HEC-et, karierat nw sipwrfaqe (gurore), shfrytwzimi minierar) etj.

Ndër veprimtaritë e lejuara në territorin e zonave të mbrojtura është dhe ushtrimi i aktivitetit të kullotjes së blegtorisë nëpërmjet lidhjes së kontratave me qira të sipërfaqeve kullosore nw zonat e mbrojtura. Për ushtrimin e veprimtarisë “dhënie në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të kullotave në zonat e mbrojtura”, wshtw mbwshtetur në ligjin nr. 81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” të ndryshuar, Udhëzimin nr.4, datë 10.04.2008 “Mbi caktimin e kriterëve teknike dhe procedurave të dhënies për kullotje dhe kositje bari” dhe Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të miratimit të parcelave kullosore të zonës së mbrojtur.

Kështu gjatë vitit 2018, kjo veprimtari u zhvillua në disa sipërfaqe kullosore të zonave të mbrojtura që gjenden në PK, PN, PM e ZMBM,dhe konkretisht:

AdZM-ja Berat ka lidhur gjithsej 20 kontrata, me sipërfaqe totale prej 1292.2 ha.

AdZM-ja Dibër ka lidhur gjithsej 7 kontrata me sipërfaqe totale 162.1.

AdZM-ja Elbasan ka lidhur gjithsej 20 me sipërfaqe prej 462.21 ha.

AdZM-ja Gjirokastrë ka lidhur gjithsej 37 kontratat: me sipërfaqe totale prej 4161 ha.

AdZM-ja Korçë ka lidhur gjithsej 24 kontrata me sipërfaqe totale prej 2414 ha.

AdZM-ja Tiranë ka lidhur gjithsej 31 kontrata me sipërfaqe totale prej 940.75 ha.

AdZM-ja Vlorë ka lidhur gjithsej 57 kontrata me sipërfaqe totale prej 1675.5 ha

AdZM-ja Lezhë ka lidhur gjithsej 1 kontratë me sipërfaqe totale prej 705 ha.

Nw tabelwn mw poshtw jepen treguesit pwr numrin e kontratave dhe sipërfaqet kullosore tw kontraktuar sipas viteve (2016, 2017 dhe 2018).


N/ R	AdZM-ja	Nr. kontratave			Sip. (ha)		
		2016	2017	2018	2016	2017	2018
1	Berat	13	27	20	881.0	1421.0	1292.20
2	Dibër	6	3	7	177.0	92.0	162.10
3	Elbasan	23	23	20	586.0	502.0	462.21
4	Gjirokastrë	12	35	37	1580.0	3058.0	4161.00
5	Korçë	19	18	24	2200.0	2364.0	2414.00
6	Tiranë	22	29	31	1865.0	3868.0	940.75
7	Vlorë	33	56	57	1196.0	2197.0	1675.50
8	Kukws	-	-	2	-	-	55.0
9	Shkodwr	-	-	2	-	-	19.00
10	Lezhw	-	-	1	-	-	705.00
	TOTALI	128	191	201	8485.0	13502.0	11837.30

Duke bërë krahasimin midis tre viteve, vërejmë se numri i kontratave të lidhura është rritur nga 128 në vitin 2016 në 191 kontrata në vitin 2017 dhe për vitin 2018 në 201 kontrata. Pra kemi shtim të numrit të kontratave nga viti në vit. Por, lidhur me sipërfaqen kullosore që është kontraktuar, vërejmë se ajo është zvogëluar me vitin 2017, konkretisht nga 8485 ha në vitin 2016, në 13502 ha në vitin 2017 dhe me 11837.3 ha në vitin 2018. Ndryshimi rezultoi nga AdZM-ja Vlorë e cila ka vlerësuar drejt kapacitetin mbajtës të numrit të kërkuar në sipërfaqes kullosore, pasi pothuajse në të gjitha sipërfaqet kontraktuar më shumë. Gjykojmë se kjo ka ardhur dhe mbështetur në studimin e kryer nga AdZM-të gjatë vitit 2018 “Studim mbi kapacitetin prodhues dhe mbajtës të kullotave në zonat e mbrojtura”. Sipas treguesve kadastrale dhe zonave ku lejohet të ushtrohet veprimtaria e kullotjes në territorin e


zonave të mbrojtura, studimit të kryer mbi kapacitete mbajtës për njësi të sipërfaqes dhe ndjekjes nga afër e strukturave të AdZM-ve, në vitet më pas do të kemi shtim të numrit të sipërfaqeve që do të lidhen kontrata qiraje për kullotje.

Për vitin 2018 kanë lidhur kontrata për herë të parë edhe AdZM-të Kukës, Shkodër dhe Lezhë. Duke analizuar treguesit e mësipërm vëhet re se AdZM-ja Shkodër ka lidhur vetëm një kontratë në sipërfaqe prej 19.0 dhe më pas vjen AdZM-ja Kukës me 55.0 ha dhe më shumë AdZM-ja Gjirokastrë me sipërfaqe prej 4161.0 ha.

Treguesit krahasues midis tre viteve cituar më lart i japim dhe grafikisht, si për numrin e kontratave (grafiku nr. 1) ashtu dhe për sipërfaqet e kullotave të kontraktuara (grafiku nr.2).



Në grafikun më poshtë jepen sipërfaqet kullimore zonë e mbrojtur, ku janë lidhur kontrata qiraje sipas AdZM-ve



Një ndër detyrat kryesore për sektorin e menaxhimit ka qënë lidhja e kontratave për **“dhënie në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve zonë e mbrojtur”**, për veprimtari të lejuara.

Sektori i menaxhimit në bashkëpunim me AdZM-të në qarqe, në zbatim të ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, mbështetur në VKM-të përkatëse të shpalljes së zonës së mbrojtur, zonimit të brendshëm, planit të menaxhimit (kur është miratuar) dhe të urdhërit të Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë datë 23.06.2016 “Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura” kanë lidhur kontrata për veprimtari të lejohen të zhvillohen në zonat e mbrojtura, ka shqyrtuar dhe vlerësuar kërkesat e bura në kështu drejtim.

Dhënia në përdorim e këtyre sipërfaqeve me kontratë qiraje, është realizuar duke përmbushur kërkesat që rrjedhin në Urdhërin e nr. 129, datë datë 23.06.2016 “Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura” (ANEKS-i), nga subjektet apo personat fizik për zhvillimin e veprimtarive të lejuara, gjatë vitit 2018 pranë AdZM-ve.

Pranë AdZM-ve janë paraqitur kërkesa të ndryshme për zhvillim veprimtarish të lejuara brenda territorit të zonave të mbrojtura dhe konkretisht:

Në AdZM-në e Lezhës janë dërguar 3 (tre) kërkesa nga subjekte apo persona fizik për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave (dokumentacionit shoqëruar), me miratim nga AKZM, këto administrata ka lidhur kontrata qiraje

për dhënie në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur për zhvillimin e veprimtarisë “vendosje të njësive portative të zmontueshme me strukturë vetëm prej druri”, dhe konkretisht

Në RNM “Kune – Vain – Tale”, me vendodhje në ekonominë pyjore Shëngjin – Tale, zona Rekreative (ZR), është shqyrtuar e vlerësuar për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 1 (njw) kërkesë për zhvillimin e veprimtarisë së lejuar “vendosje njësi portative provizore prej druri”.

Në RNM “Fushë Kuqe – Patok – Ishëm”, me vendodhje në ekonominë pyjore “Fushë Kuqe”, në zonë të përdorimit të tradicional (ZPQ) dhe zonën e përdorimit tradicional (ZPT) janë shqyrtuar e vlerësuar për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 2 (dy) kërkesa për zhvillimin e veprimtarisë së lejuar “Instalim objekti me strukturë prej druri e zmontueshme pa themel”.

Në AdZM-në e Tiranës janë dërguar 7 (shtatë) kërkesa nga subjekte apo persona fizik për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave (dokumentacionit shoqëruar), me miratim nga AKZM kjo administratë ka lidhur kontratë qiraje për dhënie në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur dhe konkretisht:

Në PK “Mali i Dajtit”, me vendodhje në ekonominë pyjore “Dajt”, në zonën e Rekracionit 1 (ZR1), është shqyrtuar e vlerësuar për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 2 (dy) kërkesa për zhvillimin e veprimtarive të lejuara “Qitje sportive në natyrë” dhe “Qitje sportive dhe pistë për makina në natyrë”.

Në PK “Mali me gropë- Bize Martanesh”, me vendodhje në ekonominë pyjore “Vërri”, në zonën e përdorimit tradicional (ZPT), janë shqyrtuar e vlerësuar për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 2 (dy) kërkesa për zhvillimin e veprimtarive të lejuara “Instalim njësive portative prej druri” dhe “Zhvillim i turizmit natyror, duke përdorur vetëm material drusor”.

Në PK “Mali i Dajtit”, me vendodhje në ekonominë pyjore “Dajt”, në zonën e Rekracionit 1 (ZR1), është shqyrtuar e vlerësuar për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 1 (njw) kërkesa për zhvillimin e veprimtarive të lejuara “Qitje sportive në natyrë” .

Në PK “Mali me gropë- Bize Martanesh” , me vendodhje në ekonominë pyjore “Linos - Rinas”, në zonën e përdorimit tradicional (ZPT) dhe zonën e përdorimit të qëndrueshëm (ZPQ), është shqyrtuar e vlerësuar për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 1 (njw) kërkesë për zhvillimin e veprimtarisë “Mbarshtrim i florës së egër dhe bimëve të ndryshme me synim zhvillimin e agroturizmit”.

AdZM-ja Fier ka pranuar dhe shqyrtuar 1 (një) kërkesë nga një subjekt për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontratë për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:

Në RNM “Pishë – Poro” , me vendodhje në ekonominë pyjore “Bregdet-Pishë Poro”, për zhvillimin e veprimtarisë “Vendosje kampi veror”.

Në AdZM-në e Korçës janë dërguar nga subjekte apo persona fizik 3 (dy) kërkesa për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave (dokumentacionit shoqërues), me miratim nga AKZM ka lidhur kontrata qiraje për dhënie në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur dhe konkretisht:

Në PK “Prespw” në ekonominë pyjore “Gorica 1”, dhe nw ekonominw pyjore “Qafzvezdw-Tresenik” në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm (ZZHQ), janë shqyrtuar e vlerësuar, për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 2 (dy) kërkesa për zhvillimin e e veprimtarive të lejuara “Ndwrtimin dhe funksionimin e Antenws nw ZK 1809, Goricw”, dhe “Ndwrtim dhe funksionimin e antenws me kodin teknik Rakicka”.

Në PMU/T “Pogradec” në ekonominë pyjore “Guri i kuq –Lin”, në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm (ZZHQ), është shqyrtuar e vlerësuar, për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 1 (një) kërkesë për zhvillimin e veprimtarisw së lejuara “Vendosjen e platformws me konstruksion prej druri pwr pushim, çlodhje dhe vrojtim tw natyrws nga vizitorwt e turistwt”.

Në AdZM-në e Shkodrës janë dërguar nga subjekte 1 (njw) kërkesw për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave (dokumentacionit shoqërues), me miratim nga AKZM ka lidhur kontratw qiraje për dhënie në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur dhe konkretisht:

Në PMU/T “Lumi Buna - Velipojë” në ekonominë pyjore “Dajç-Velipojw”, wshtw shqyrtuar e vlerësuar, për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 1 (njw) kërkesw për zhvillimin e veprimtarisw së lejuar “Vendosje e njwsisw portative prej druri”.

AdZM-ja Vlorë ka pranuar dhe shqyrtuar 1 (një) kërkesë nga një subjekt për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontratë për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:

Në PK “Butrint” në ekonomisë pyjore “Stillo Vrinw”, ku ka vlerësuar se është dakort për zhvillimin e veprimtarisë “Zhytje pwr eksplorim tw botws nwnujore”.


AdZM-ja Kukës ka shqyrtuar dhe vlerësuar kërkesën e 1 (një) subjekti për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontratë për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:

Në PK “Lugina e Valbonws” në ekonomisë pyjore “Valbonw - Çerem”, ku ka vlerësuar se është dakort për zhvillimin e veprimtarisë “Ndwrtim Antene telefonike Valbona 1560”.

Nr	Zona e Mbrojtur (ZM)	AdZM	Nr. kontratave		
			2016	2017	2018
1	RNM “Kune – Vain–Tale”	Lezhë	1	7	1
	RNM “Fushë Kuqe – Patok – Ishëm”		1	2	2
2	PK “Mali i Dajtit”	Tiranë	1	3	3
	PM “Mali me gropa – Bizë - Martanesh		1	0	3
3	PK “Divjakë - Karavasta”	Fier	1	1	1
4	PK “Prespw”	Korçë	0		2
	PMU/T “Pogradec”		0	2	1
5	RNM “Kuturman”	Elbasan	0	1	-
6	PMU/T “Lumi Buna - Velipojë”	Shkodër	0	2	1
7	PK “Butrint”	Vlorë	0		1
	PK “Syri i Kaltër”		0	1	-
8	PK “Bredhi i Hotovës – Dangëlli”	Gjirokastër	0	1	-
9	PK “Lugina e Valbonws”	Kukës	0		1
	PN “Korab - Koritnik”		0	1	
Totali			5	21	16

Siç shihet në tabelën e mëposhtme janë lidhur gjithsej 42 kontrata me qira për dhënie ose përdorim të sipërfaqes zonave të mbrojtura dhe konkretisht në vitin 2016 janë lidhur 5 kontrata, në vitin 2017 janë lidhur 21 dhe në vitin 2018 janë lidhur 16 kontrata.

Më poshtë japim paraqitjen e numrit të kontratave të lidhura nga AdZM-të sipas tre viteve dhe dallojmë krahasimin e tyre.



Gjatë këtij viti janë lidhur kontrata me qira për dhënie në përdorim sipërfaqe të fondit pyjor/kullor zonë e mbrojtur edhe me subjektet për ndërtim HEC-i miratuar me Urdhër të Ministrit të Mjedisit “Për heqje dhe dhënie në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur dhe konkretisht:

AdZM-ja Tiranw, ka pranuar dhe shqyrtuar 1 (një) kërkesë nga një subjekt për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontratw për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:

Në PK “Mali i Dajtit” në ekonominë pyjore “Zallherr-Priskw”, është shqyrtuar e vlerësuar për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 1 (njw) kërkesw për zhvillimin e veprimtarisw ..”Hec Mali “, Tirana Energji”.

AdZM-ja Gjirokastër, ka pranuar dhe shqyrtuar 1 (një) kërkesë nga një subjekt për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontratw për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:

Në PK “Bredhi i Hotovws – Dangwlli” në ekonominë pyjore “Frashwr – Koblarw”, pwr zhvillimin e veprimtarisw “Ndwrtim Hec Malindi 2”.

AdZM-ja Elbasan ka pranuar dhe shqyrtuar 1 (një) kërkesë bërë nga një subjekt për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontratë për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:

Në RNM “Kuturman” në ekonominë pyjore “Kuturman”, në zonën e përdorimit tradicional (ZPT), është shqyrtuar e vlerësuar kërkesa e dhënies në përdorim me kontratë qiraje për zhvillimin e veprimtarisë “Ndwrtim i Hec Miraka”.

Nr	Subjekti	Veprimtaria	Zona e Mbrojtur	AdZM-ja
1	“Tirana Energji”	Ndërtim HEC-i	PK “Mali i Dajtit”	Tiranw
2	Kreshova	Ndwrtim Hec Malindi 2	PK “Bredhi i Hotovws – Dangwlli”	Gjirokastwr
3	“Kuarci Blace”	Ndwrtim i Hec Miraka	RNM “Kuturman”	Elbasan
4	“Kulota”	Ndwrtim i Hec	RNM “Kuturman”	Elbasan

Nga AKZM (nwpwrmjet AdZM-ve) janw, pwr periudhwn 2015 – 2018, kanw vazhduar procedurat pwr ndwrtimin e tyre gjithsej 8 HEC-e, pasi kanw qwnw me kontrata konçensionare tw miratuara para viti 2015, kanw bwrw ndryshim nw projektin e zbatimit (duke u zhvendosur nga kufiri i ZM-ve), janw projektuar me fuqi tw instaluar nwn 2 MG etj.

Nr	Subjekti	Veprimtaria	Zona e Mbrojtur	AdZM-ja
1	“Reka Energy”	Ndërtim HEC-e	PN “Korab – Koritnik”	Kukës
2	“Fatjon & Rruga Ura nr.2 Elbasan”	Ndërtim HEC-i	PN “Korab – Koritnik”	Kukës
3	“Dragobia Energy”	Ndërtim HEC-i	PK “Lugina Valbonës”	Kukës
4	“SGD”	Ndërtim HEC-i	PM “Mali me gropa – Bizë – Martanesh”	Dibër
5	“Kulota”	Ndërtim HEC-i	PN “Korab – Koritnik”	Kukës
6	“Tirana Energji”	Ndërtim HEC-i	PK “Mali i Dajtit”	Tiranë
7	Kreshova	Ndërtim Hec Malindi 2	PK “Bredhi i Hotovës – Dangulli”	Gjirokastrë
8	“Kuarci Blace”	Ndërtim i Hec Miraka	RNM “Kuturman”	Elbasan
	Totali 8 HEC-e			

Lidhur me HEC-et qw gjenden brenda territorit tw zonave tw mbrojtura, wshtw vwrejtur se deri nw vitin 2015 (para krijimit te AKZM-sw), janw ndwrtuar dhe prodhojnw energji njw numwr i konsiderushwm i tyre qw gjenden nw PK, PN dhe PM. Kwshtu tw identifikuar nw ZM-tw janw gjithsej 61 HEC-e. Nga AKZM (nwpwrmjet AdZM-ve) janw dhwnw mendim kundwr ndwrtimit tw tyre gjatw pwrriudhws 2015 – 2018 gjithsej 45 HEC-e dhe pro pwr 8 raste, gjithashtu gjatw shqyrtimit tw projektit tw zbatimit dhe verifikimeve nw terren nga AdZM-tw, kemi dhwnw mendim edhe pwr 42 Hec-e qw janw jashtw territorit tw zpnave tw mbrojtura.

Pwr HEC-et tw cilwt janw ndwrtuar dhe prodhojnw energji para vitit 2015, me kontrat tw lidhura nga ish-DRSHP-të brenda PM (ku janw kryer dhe punimet rehabilituese tw sipwrfaqes), sektori i menaxhimit nw bashkwpunim me AdZM-nw Dibër dhe Drejtorinw e Financws ka kërkuar nga subjekti likuidimin financiar qw buron nga kontrata.

Lidhur me pagesat e vlerës financiare të kontratave të lidhura nga ish-DRSHP-të kemi kërkuar që AdZM-të, të rivlerësojnë gjithë dokumentacionin ekzistues në arshivat e këtyre drejtorive apo dërguar nga subjekti. Kështu në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe shërbimeve të brendshme dhe AdZM-të përkatëse po ndjekim dhe kontrollojmë pagesat vjetore, likuidimi financiar të tyre për çdo vit dhe detyrimet e pa paguara, detyrë e kërkuar dhe nga auditimi i KLSH-së. AdZM-të janë porositur ta ndjekin në vijimësi këtë problem. Gjatë monitorimit dhe verifikimeve nga AdZM-të janë konstatuar dhe subjekte të cilët kryjnë veprimtari për nxjerrje minerali të kromit në PK “Shebenik – Jabllanicë” ku tashmë po kërkojnë të lidhin kontratën. Lidhur me këtë problem kemi diskutuar vazhdimisht dhe me sektorin e menaxhimit të AdZM-ve Elbasan, Dibër dhe Korçë. Për këtë problem po studiojmë me hollësi çdo dosje paraqitur nga subjektet, në zbatim të Ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, duke analizuar, kategorinë e zonës së mbrojtur, zonimin e brendshëm të vendodhjes së karrierës, projektin teknik të zbatimit së bashku me gjurmën e shtrirjes së aseteve mbështetëse, afatin e lejes konçensionare, afatin e lejes mjedisore, VNM-në, projektin e rehabilitimit etj. Kështu është punuar për vazhdimin e pagesave dhe lidhjen e kontratës për subjektin “Koka Energy” sh.p.k. për HEC “Stavec”, e cila u finalizua nëpërmjet AdZM-së Dibër.

Detyrë shumë e rëndësishme për sektorin e menaxhimit gjatë vitit 2018 ka qënë; shqyrtimi, dhe vlerësimi i kërkesave, dërguar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) në rrugë elektronike për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme në territorin e zonave të mbrojtura. **“Dhënie mendimi”** janë përgatitur bazuar në ligjin nr. 81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, të akteve të tjera nënligjore si VKM-së së shpalljes së zonës së mbrojtur, zonimit të brendshëm e planit të menaxhimit, bazuar në strategjinë kombëtare për zonat e mbrojtura, zhvillimit për një menaxhim të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe së fundmi dhe të PPV-ve të bashkive.

Edhe gjatë gjithë vitit 2018 një ndwër detyrat e shumta për sektorin ka qënë, përgatitja dhe dërgimi në afat pranë institucioneve si (MTM-sw, MEI, MBZHR-sw, AKM-sw, AZHT-sw, AKB-sw, subjekteve dhe individëve të ndryshëm, pushtetit vendor, shoqatave mjedisore, shoqërisë civile etj.), për kërkesat që kanë bërë institucione, kompani investimesh, shoqëri, subjekte, apo individëve të ndryshëm për zhvillimin e veprimtarive të lejuara ose jo, brenda territoreve të zonave të mbrojtura

mjedisore. Kërkesat e tyre kanë konstatuar në zhvillimin e veprimtarive të ndryshme ekonomike, agroturistike, edukimin mjedisor, veprimtari argëtuuese/çlodhëse, social kulturore, trashëgimtare dhe veprimtari studimore e kërkimore.

Lidhur me **“Dhënie mendimi”**, kemi patur rastet ku kërkuar kanë paraqitur dokumentacionin jo të plotë, ndaj të cilëve kemi kërkuar plotësimin e dokumentave të nevojshëm.

❖ Gjatë vitit 2018 janë përgatitur për “Dhënie Mendimi” gjithsej 168 raste nga këto:


- Vendosje të njësive portative provizore të zmontueshme; 7 raste,
- Studim, ndwërtim për energji gjeneruese nga era; 2 raste,
- Aktiviteti minerar (miniera kromi dhe guri): 32,
- Ndërtim HEC-e dhe rivënie në punë të HEC-e: 62
- Ndërtime resortesh, bar-restorante, kabanone mobiljesh komplekse turizmi etj.: 43,

- Ndërtim segmente rrugësh, rikonstruksion, rikualifikim e rehabilitim pika kalimi etj: 7,
 - Vendorsje antenash, pika transmetimi, nënstacione etj : 9,
 - Fabrika riciklimi, riciklim mbetjesh spitalore etj: 3.
 - Ndwrtim objektesh me funksion imbotilim uji tw pijshwm: 1
- Sqarojmw se pothuaj pwr tw gjitha rastet (kwrkesat) e bwra, pwr mungesw tw dokumentacionit janw shqyrtuar e analizuar me 2 deri 3 herw. Pwr çdo rast kemi kwrkuar mendimin dhe tw AZM-sw pwrkatwse tw cilws i kemi dwrguar nw rrugw elektronike kwrkeswn dhe dokumentacionin teknik pwr verifikim nw terren dhe vlerwsin tw tij. Nw tabelwn mw poshtw japim numrin e rasteve tw hasura sipas aktiviteteve të kërkua nga subjektet (shprehur sipas grupimit tw veprimtarive)


Nr	Lloj i veprimtarive	viti 2016	viti 2017	viti 2018
1	Vendorsje njwsi portative provizore tw zmontueshme		12	7
2	Studim, ndwrtim pwr energji gjeneruese nga era		-	2
3	Fabrika riciklimi, riciklim mbetjesh spitalore		-	3
4	Aktiviteti minerare (miniera kromi dhe gurore)		23	32
5	Ndërtim HEC-e dhe rivënie në punë të HEC-e		37	62
6	Ndërtime resortesh, bar-restorante, kapanone mobiljesh komplekse turizmi etj		20	43
7	Ndërtim segmente rrugësh, rikonstruksion, rikualifikim e rehabilitim pika kalimi etj		20	7
8	Ndërtim fabrike për bolitimin e ujit, vënie impiantesh dhe mendime mbi strtegjinë e ujit etj.		6	1
9	Vendorsje antenash, pika transmetimi, nënstacione etj		9	11
	TOTALI		147	168

Më poshtë po japim grafikisht rastet “Për Dhënie mendimi”, shprehur në numër rastesh, sipas aktiviteteve të kërkua nga subjektet:

Për vitin 2018



Krahasimi midis viteve 2017 - 2018



Sipas grafikut vihet re se kërkesat e subjekteve të ndryshëm për të zhvilluar veprimtari në territorin e zonave të mbrojtura ka tendencë në rritje nga 103 raste gjatë vitit 2016 në 147 raste gjatë vitit 2017 dhe 168 raste gjatë vitit 2018. Vihet re gjatë këtij viti janë kërkuar dhe veprimtari si ajo për prodhim energjie nga burime të rinj, për riciklim të mbetjeve spitalore etj, po kështu

konstatohet se kjo tendencë rritje për grupimin e këkesave nr. 4, 5 dhe 6 qw kanw tw bwjnw me HEC-et dhe minierat dhe pwr veprimtari zhvillimi drejt agro turizmit.

Lidhur me dy tw parat kjo vjen si rrjedhojw e kontratave konçensionare tw lidhura vite mw parw, por qw bien ndesh me lejueshmwrinw nw zonat e mbrojtura.

Ndwrsa kwrkesat pwr zhvillimin e agroturizmit, janw miqwsisht me mjedisin dhe konformw dhe aktet ligjore tw zonave tw mbrojtura.


Detyrë tjetër shumë e rëndësishme për sektorin e menaxhimit gjatë vitit 2018 ka qënë; shqyrtimi, vlerësimi dhe përgatitja e përgjigjeve për këkesat ardhur në rrugë shkresore, dërguar nga subjekte, individë, institucione, shoqata të ndryshme etj, për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme në territorin e zonave të mbrojtura. **“Përgjigjet”** janë përgatitur bazuar në ligjin nr. 81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, të akteve të tjera nënligjore si VKM-në e shpalljes të zonws së mbrojtur, zonimit të brendshëm e planit të menaxhimit, bazuar në strategjinë kombëtare për zonat e mbrojtura, zhvillimit për një menaxhim të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe së fundmi dhe të PPV-ve të bashkive si dhe të akteve tw tjera ligjore dhe direktivave tw Bashkimit Evropian.


Gjatë vitit 2018, janë përgatitur dhe kthyer përgjigje 512 shkresave të ndryshme ardhur nga subjekte, individë, institucione, shoqata të ndryshme etj dhe konkretisht jepen të grupuara si në tabelën më poshtë:

Nr	Lloj i veprimtarive	viti 2016	viti 2017	viti 2018
1	Aktiviteti minerare (miniera kromi dhe gurore)		8	5
2	Ndërtim HEC-e dhe rivënie në punë të HEC-e		17	64
3	Ndërtime resortesh, bar-restorante, kapanone mobiljesh komplekse turizmi etj		26	15
4	Ndërtim segmente rrugësh, rikonstruksion, rikualifikim e rehabilitim pika kalimi etj		16	5
5	Ndërtim kompleksi blegtorale, për pularitë, për peshkun, projekte agropylltarie, etj		23	-
6	Ndërtim fabrike për bolitimin e ujit, vënie impiantesh dhe mendime mbi strtegjinë e ujit etj.		4	3
7	Vendosje antenash, pika transmetimi, nënstacione etj		9	5
8	Nyje betoni		-	1
9	Pwr shpallje ZM		-	4
10	Bashkëpunim ndërinstytucionale		42	345
11	Të ndryshme		36	65

TOTALI		181	512
--------	--	-----	-----

Më poshtë japim grafikisht përqindjen që zë çdo grupim. (sipas paraqitjes në tabelw), ku janë përgatitur përgjigjet shkresore për vitin 2018. Vihet re grupimi nr. 10 “Bashkëpunim ndërinstitucional”, zë peshën më të madhe. Kjo tregon tendencës në rritje të lidhjes dhe komunikimit shkresor me institucione të ndryshme shtetërore si me MTM, MBZHR, MIE, AKPT, AZHT, ALUIZNI, AKB, bashkitë, njësitë administrative etj.





Duke bërë krahasimin midis dy viteve ka tendencë rritje nga 115 shkresa ardhur gjatë vitit 2016 në 181 të tilla gjatë vitit 2017. Gjithashtu kjo tendencë ka ndjekur rritje edhe sipas grupimit të veprimtarive që trajtohen në shkresat e ardhura, përveç grupimit nr. 7 “Vendosje antenash, pika transmetimi, nënstacione etj”, e cila ka rënie rastesh. Për grupimet nr. 3 dhe 4, kanë qënë numër rastësh më shumë.

Një nga drejtimet kryesore të punës me zonat e mbrojtura mjedisore është dhe zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në natyrë si atraksioni kryesor në vendin tonë. Deri më sot janë evidentuar rreth 54 pika turistike brenda territorit të zonave të mbrojtura mjedisore, por jo të gjitha të frekuentuara sa duhet. Grumbullimi dhe mbledhje e të dhënave (numrit të vizitorëve/turistëve), është realizuar duke u mbështetur në:

1. Informacionet (numri i vizitorëve/turistëve) që janë regjistruar pranë strukturave tatim-taksave të pushtetit vendor për pikat turistike që gjenden brenda sistemit të zonave të mbrojtura.
2. Informacionin i të dhëna (numri i vizitorëve/turistëve) që rezultojnë nga subjektet e resorteve dhe bujtinave ku kanë drekuar apo fjetur.
3. Të dhënat (numri i vizitorëve/turistëve), që rezultojnë sipas sontazheve të kryera nga stafet e AdZM-ve, të dhënat e skedave intervistave të realizuara në pika dhe zona të ndryshme.

Referuar të dhënave të dërguar nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) në nivel qarku, për numrin e vizitorëve që kanë hyrë në territoret e ZM-ve, për periudhën Janar – Dhjetor 2018, numuri i vizitorëve vendas dhe të huaj ka qënë gjithsej 3574399 vizitorë:

- Vizitorë vendas gjithsej 2467132 vizitorë

- Vizitorë të huaj gjithsej 1107267 vizitorë
Nga këto:


Në tabelën më poshtë, japim numrin e vizitorëve/turistëve, për çdo zonë të mbrojtur (ZM), shumën e vizitorëve për çdo kategori të zonave të mbrojtura dhe numrin totale të tyre.

Nr.	Kategoria/Emërtimi	Nr. Vizitorëve, viti 2017	Nr. Vizitorëve, viti 2018
I	Rezervë Natyrore Strikte		
	“Lumi i Gashit”	4750	19070
1	Sub-Total	4750	19070
II	Park Kombëtar		
1	“Bredhi i Drenovës”	1150	950
2	“Bredhi i Hotovës”	1501	1177
3	“Butrint”	167798	211495
4	“Divjakë – Karavasta”	407267	364979
5	“Lugina e Valbonës”	123180	116736
6	“Mali i Dajtit”	107949	123475
7	“Mali i Tomorrit” (Kulmak)	161876	173684
8	“Prespa”	95350	106050
9	“Qafshamë”	9470	39500
10	“Shebenik – Jabllanicë”	7894	26187
11	“Theth”	77800	91950
12	“Llogara”	64594	200910
13	“Lura”	1685	1970
14	PKD “Karaburun – Sazan”	28933	67372
	Sub-Total	1256447	1526435

	Monument Natyre	Nr. Vizitorëve, viti 2017	Nr. Vizitorëve, viti 2018
III	"Kanionet e Osumit"	1517	12478
1	“Bredhi i Sotirës”	544	1344
2	"Kanioni i Holtës"	844	2113
3	“Ujëvara e Sotirës”	1669	3469
4	“Liqeni i Zi”	843	870
5	Kanionet e Sinecit	380	510
6	“Rrepet e Byshekut”	1356	2305
7	“Shpella e Sarasalltikut”	34750	22400


8	“Syri i Kaltër”	64495	84616
9	“Ishujt e Ksamilit”	24990	11400
10	“Shpella e Haxhi Alisë”	11187	
11	“Shpella dhe Gjiri i Gramës”	1913	
12	“Ishulli Zvërnec”	11452	
13	“Ujrat Termale” Langaricë	23525	28800
14	“Kepi i Rodonit”	7650	27500
15	“Plazhi Shën Pjetër”	104060	303400
16	“Bredhi i Zhejit”	552	728
17	“Kanionet e Nivicës”	200	912
18	“Pisha e fushëkuqes” Gjinar	1808	2820
19	Të tjerë	76956	62902
	Sub-Total	276691	568567
IV	Rezervat Natyror i Menaxhuar /Park Natyror		
1	“Korab – Koritnik”	19919	4167
2	"Liqeni i Shkodrës"	120800	249450
3	“Cangoj”	5150	3300
4	“Kune – Vain- Tale”	3058	44039
5	“Rrushkull”	5200	5050
6	“Karaburun”	22600	91034
7	“Pishë Poro”	17560	138377
	Sub-Total	194287	583672
	Peisazh i Mbrojtur		
V	"Lumi Buna-Velipojë"	374000	403900
1	"Mali me gropa-Bizë-Martanesh"	2225	3451
2	“Liqeni i Pogradecit”	444170	390278
	Të tjera	2063	15600
	Sub-Total	988506	873229
	Total i përgjithshëm	2722744	3574399

Grafiku 11



- Rezervë Natyrore Strikte
- Park Kombëtar
- Monument Natyre
- Rezervat Natyror i Menaxhuar /Park Natyror
- Peisazh i Mbrojtur
- Te tjere

Krahasimi vjetor



Paraqitja grafike e të dhënave (numri i vizitorëve/turistëve), sipas kategorive të zonave të mbrojtura (ZM), jepet në grafikun më poshtë. Shprehur në përqindje, numri i vizitorëve/turistëve që zënë ndaj numrit të tyre gjithsej për çdo kategori është:

- Kategoria I, Rezervë Strikte Natyrore (RSN), numri i vizitorëve/turistëve që kanë frekuentuar zë -----, ndaj numrit total të vizitorëve/turistëve për periudhën Janar – Dhjetor 2018.
- Kategoria II, Park Kombëtar (PK), numri i vizitorëve/turistëve që kanë frekuentuar zë-----
- Kategoria III, Monument Natyre (MN), numri i vizitorëve/turistëve zë ---- ndaj numrit total.
- Kategoria IV, Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (RNM/PN), numri i vizitorëve/turistëve që kanë frekuentuar gjatë kësaj periudhe, zë -----.
- Kategoria e V, PM (peizazh i mbrojtur), numri i vizitorëve/turistëve zë ----, ndaj numrit total.
- Nëse bëjmë krahasimin e të dhënave (numrit të vizitorëve/turistëve) që kanë frekuentuar brenda kategorisë së zonave të mbrojtura (pikave turistike), vërejmë se:

• Në kategorinë e II-të PK, (park kombëtar), këto zona janë frekuentuar më shumë nga të gjitha kategoritë e tjera dhe zënë ---- të numrit të vizitorëve/turistëve. Më pas vjen kategoria PM (Peizazh i mbrojtur) me -----, kategoria RNM/PN me ----, kategoria MN me ----dhe në fund kategoria RNS me ----.

Brenda kategorisë e II-të PK (park kombëtar), numri më i madh i vizitorëve/turistëve është në PK “Divjakë – Karavasta” me 364979, ndërsa me më pak vizitorë/turistë, është PK “Drenovë” me --- - vizitorë.

Në kategorinë e III-të, MN (monument natyror), numri më i madh vizitorësh/turistë, është në MN “Shpella e Sarasalltikut” me 34750, në MN “Syri i kaltër” me 29.910 vizitorë/turistë e kështu me radhë dhe numrim më të vogël e ka patur MN “Dushku i Lleshanit” me 43 vizitorë/turistë.

Në katëgorinë e IV-rt RNM/PN, është frekuentuar më shumë "Liqeni i Shkodrës" me 105225 vizitorët/turistëtë. Gjithashtu vihet re se është frekuentuar shumë edhe PN “Korab – Koritnik” me 40.230 vizitorë/turistë, ku për vitin 2016 ky park natyror është frekuentuar me 175 vizitorë.

Në kategorinë e V-të PM (peizazh i mbrojtur) më shumë është frekuentuar PM “Liqeni i Pogradecit” me 390.000 vizitorë/turistë.

Për vitin 2017, për periudhën Janar – Shtator 2017, vihet re tendenca e rritjes së numrit vizitorëve/turistëve që frekuentojnë PK, PM, dhe MN. Gjykojmë se kjo ka ardhur si rrjedhoj

- ❖ Në kuadër të krijimit të bashkive të reja dhe transferimit të fondit pyjor/kullosor me VKM nr. 433, datë 06.08.2016 u konstatua se disa parcela të ekonomi pyjore/kullosore që janë në zonë të mbrojtur i kishin kaluar bashkive respektive apo dhe raste parcelash kur nuk

janë të zonës së mbrojtur sipas formularit nr. 4 po nuk janë pasqyruar dhe në listat e transferimit të bashkive të reja sipas VKM-së 433, datë 06.08.2016.

Ndodhur para gjendjes ku disa parcela pyjore (pjesë përbërëse e zonavë të mbrojtura) brenda kufinjëve natyror të tyre, ishin transferuar bashkive, u kërkuar që AdZM-të të bashkëpunonin me strukturat pyjore të bashkive respective.

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 1, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e kadstrës së fondit pyjor dhe kullor kombëtar”, sektori i menaxhimit i kërkoi çdo AdZM-je plotësimin e formularëve kadastral, me gjendjen që ka si dhe specialistët që janë ngarkuar për mbajtjen, rregullimin dhe saktësimin e sipërfaqeve kadastrale të zonave të mbrojtura duke koordinuar e krahasuar të dhënat kadastrale të formularit nr. 4 për zonat e mbrojtura me të dhënat (parcelat pyjore/kullosore), transferuar pranë bashkive të reja të bëjnë rakordimet pranë AKZM-së.

Gjatë punës u konstatua se ka raste ku parcela të ekonomive pyjore/kullosore janë të mbivendosura, apo sipërfaqja totale e zonës së mbrojtur sipas VKM-së së shpallur nuk rrezulton e tillë, pasi ka mbi vendosje të tyre punuar sipas hartave të ekonomive pyjore. Ndodhur para kësaj gjendje po punojmë duke saktësuar hartat e këtyre ekonomive me hartën e zonës së mbrojtur të miratuar.

Duke bërë përputhjen e tyre janë vërejtur probleme si:

Kjo ishte në përgjithësi panorama e gjendjes kadastrale për zonat e mbrojtura, problematikat lidhur me to dhe sugjerimet e dhëna për vazhdimin e këtij procesi. Duke bashkëpunuar me specialistët e GIS-it për të realizuar përputhshmërinë e treguesve kadastralë, sipërfaqet, përbërja e grumbujve pyjor, pronësia etj, është një punë që duhet të ndiqet me përparësi gjatë këtij viti ku përkon dhe me procesin e Inventarizimit Kombëtar të Pyjeve në Shqipëri.

Gjatw kwitj viti u realizua hartimi dhe pwrgratitja e Skedave Biologjike pwr tw gjithw monumentat natyror (MN), duke saktwsuar vendodhjen me koordinata tw gjeoreferuara tw tyre, vija kufizuese dhe sipwrfaqja qw zw nw territory monumenti shoqwruar dhe me foto. Ështw punuar dhe pwr skedat biologjike tw MN-ve tw propzuara nga pushteti vendor (bashkisw pwrkatwse).

Lidhur me monumentat e natyrws (MN), pun aka pwrfunduar dhe janw paraqitur pwr miratim nw Kwshillin e Ministrave. Gjithashtu wshtw punuar dhe plotwsimi i tw dhwnave pwr skedat biologjike pwr tw gjitha zonat e mbrojtura, pwrgratitur nga AdZM-tw pwrkatwse dhe miratuar nw AKZM.

Del si detyrw qw gjatw vitit 2019 tw hartohen dhe skedat biologjike per ZM-tw e reja, shpallur me VKM pwrkatwse gjatw vitit 2018.

Kemi realizuar dhe pwrditwsimin e tabelws sw rrjetit tw ZM-ve pwr gjendjen e krijuar deri ne fund tw vitit 2018. Po kwshtu do tw punojmw pwr tw saktwsuar kufirin e kwtyre zonave dhe gjendjen e tyre kadastrale (ekonomitw pyjore, parcelat pwrkatwse), sipas VKM-sw qw wshtw shpallur. Detyrw tjetwr pwr kadstrwn ka qenw dhe saktësimi i sipërfaqeve kadastrale për zonat e mbrojtura, ndryshimet e bëra, plotësimi i formularëve për ndryshimet kadastrale, në zbatim të

Udhëzimin nr. 1, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullor kombëtar” dhe Udhëzimin nr. 3, datë 03.04.2013 “Për rregullat dhe mënyrën e mbajtjes, skedimit, funksionimit dhe përdorimit të rregjistrit të zonave të mbrojtura” (apo duke i’u referuar dhe ndryshimeve që janë bërë).

- ❖ Detyrë e rëndësishme për vitin 2018 ka qënë dhe propozimi e rishikimi tërësor i zonave të mbrojtura dhe monumenteve të natyrës (MN) lidhur me ndryshimin e statusit, sipërfaqeve, zonimit të brendshëm, meqenëse jemi në kuadër të përgatitjes dhe shpalljes së akteve nënligjore të Ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.

Me ndihmën e specialistit të GIS-it është punuar dhe përgatitur harta me kufinj të fizik dhe koordinata të gjeoreferuara për çdo zonë të mbrojtur, ndryshimet që propozohen të bëhen dhe koordinimi i punës me AdZM-të. Po kështu është punuar dhe për monumentet e natyrës (MN). Në këtë aspekt është punuar dhe për rastet ku pushteti vendor apo shoqata mjedisore ka bërë propozime për zona të mbrojtura e monumente natyre sin ë rastin për Malin e Munells, territori i 4 bashkive, për zonën pyjore në Dardhë deri tek bregu i Drinit, territori i bashkisë Fushë – Arrës, për masivin e Gështenjës së Tropojës, monumentet e natyrës në territorin e bashkisë Patos etj.

Një detyrë tjetër është dhe pjesëmarrja në dëgjimet publike pranë AKPT-së në kuadër të hartimit të planeve të përgjithshme vendore (PPV) dhe VSM-ve të bashkive. Në të gjitha këto takime kemi qënë pjesëmarrës, kemi diskutuar lidhur me përputhshmërinë e ligjit të nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” me perspektivën që do të kenë planin zhvillimor të bashkive të reja hartuar nga studiot konsulente.

Në këto takime kemi kërkuar që në këto plane zhvillimore të bashkive të merren në konsideratë: Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.

VKM-të përkatëse për shpalljen e zonave të mbrojtura dhe monumenteve të natyrës.

Kategoritë e zonave të mbrojtura (statusin e mbrojtjes).

Zonimi i brendshëm i zonës së mbrojtur.

Veprimtaritë e ndaluara dhe ato të lejuara brenda zonës së mbrojtur.

Statusin e veçantë për monumentet e natyrës (MN) veçanërisht për shpellat, kanionet e hidromonumentet. Gjatë diskutimeve kemi shprehur sugjerime dhe për zonat e mbrojtura, propozuar për tu shpallur të tilla.

Gjatë zhvillimit të këtij procesi kanë qënë prezent dhe përfaqësues të AdZM-ve ku kanë dhënë sugjerimet e tyre, duke diskutuar për raste konkrete ku mund të zhvillohen veprimtari e aktivitete të lejuara në këto zona.

Nga ana e saj AKPT si organizatore dhe drejtuese e këtij procesi ka qënë mbështetëse për ruajtjen dhe zhvillimin e natyrës dhe biodiversitetit në mjedis dhe veçanërisht për zonat e mbrojtura.

Theksojmë se në përgjithësi studiot konsulente për hartimin e këtyre planeve i kanë marrë në konsideratë sugjerimet, vërejtjet dhe mendimet tona dhe i kanë materializuar në këto plane.

- ❖ Detyrë tjetër që u ndoq me vëmendje nga sektori i menaxhimit ishte dhe kërkesa e bërë nga disa AdZM për gjetjen e një zgjidhje ligjore “Furnizimi me dru zjarri i banorëve me banim të përhershëm që ndodhen brenda zonave të mbrojtura”.

Dihet që misioni dhe detyra kryesore e AKZM-së është ruajtja e natyrës dhe biodiversitetit në territorin e zonave të mbrojtura, por krahas konservimit, si domosdoshmëri të synohet dhe drejt një menaxhimi të qëndrueshëm të këtyre zonave. Meqenëse për disa zona të mbrojtura janë hartuar dhe planet e menaxhimit, ku përcaktohen qart dhe saktë prioritetet që ka çdo zonë e brendshme, bëhet e mundur dhe mundësia për kryerje të disa veprimtarive që nuk çojnë në përkeqësim të vlerave të natyrës e mjedisit. Gjithashtu banorët e komuniteteve që ndodhen brenda territorit të zonave të mbrojtura janë dhe konsiderohen si partner të AdZM-ve. Për shkak të Moratoriumit të Pyjeve dhe nevojës së popullatës vendase (brenda zonave të mbrojtura) për dru zjarri nga ana e AdZM-ve janë bërë kërkesa të vazhdueshme për tu furnizuar me dru zjarri. Në zbatim të ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 46 “Pyjet, kullotat, ujërat dhe pasuritë e tjera natyrore brenda zonave të mbrojtura”, pikat 1, 2, 3, dhe 4 u përgatit Urdhëri nr. 198, datë 31.08.2017 i Drejtorit të Përgjithshëm për të mundësuar furnizimin me dru zjarri familjet me banim të përhershme brenda territorit të zonave të mbrojtura.

Në zbatim të këtij Urdhëri, u është kërkuar AdZM-ve që të zbatojnë me përpikmëri të gjitha kushtet dhe kriteret që burojnë nga ky urdhër.

AdZM-të që paraqitën projektet për rehabilitim të zonës pyjore (propozuar prej tyre) u shqyrtuan dhe u bë vlerësimi i tyre bazuar në kriteret teknike e silvobiologjike të sipërfaqeve pyjore.

Gjatë viti 2016 dërguan projekte “Për rehabilitimin dhe shëndetësimin e sipërfaqeve pyjore për prodhim dru zjarri”, planifikuar për furnizimin e banorëve me banim të përhershëm në zonat e mbrojtura, për shqyrtim dhe miratim AdZM-të, Korçë, Elbasan, Gjirokastër, Berat, Fier dhe Lezhë.

Pas miratimit të këtyre projekteve, sektori i menaxhimit përgatiti MEMO-n dhe Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm për zbatim dhe ndërkohë u kërkoi AdZM-ve që në përfundim të procesit të paraqitnin një raport të hollësishëm mbi zbatimin e këtij urdhëri për punën e bërë sipas fazave të parashikuara në projekt. Nga verifikimet e kryera në terren dhe materiali shkresor rezultoi që kushtet dhe kriteret e kushtëzuara në këtë urdhër janë respektuar, marrë e vlerësuar me korrektësi nga AdZM-të.

Punë me rëndësi gjatë këtij viti ka qenë, përcaktimi i objekteve në zonat e mbrojtura për mbjellje me fidana dhe pemë pyjore e frutore. Kjo punë është ndjekur nga afër dhe tashmë po materializohet me mbjelljen e fidanave sipas programit dhe grafikut të punimeve.

Gjatë këtij viti kemi ndjekur nga afër edhe procesin e IKPK të vendit, i cili drejtohet dhe ndiqet nga afër nga AKM. Specialistët tanë të 6 AdZM-ve kanë kryer punimet e terrenit sipas programit dhe metodologjisë që është miratuar.

❖ Në fushën e faunës së egër

AKZM, është që nga Korrik-Gushti i vitit të kaluar e në vazhdim, në kryerjen e punës së saj, për ndjekje permanente, të Vëzhgim-Monitorimit të Faunës së Egër, në teritoret e sistemit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore dhe jo vetëm, sipas specive të përcaktuara për këtë qëllim.

Mirëfilli, ky proces po realizohet, nëpërmjet punës së përditëshme të Rangers-ave (Rojeve Mjedisore), sipas AdZM-ve.

AKZM, duke përfshirë, në detyrat e saj funksionale edhe Vëzhgimin e Jetës së Egër, ka si objektivi “Sigurimin e informacionit të duhur, përmes monitorimit, lidhur me tendencat (trendin) në popullatën e faunës së egër, rajonizimin e saj në vend si dhe trushtinë e kërcënimit, me të cilat ajo përballlet, në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i ruajtjes dhe vendimarrja ndaj saj”. Pa e njohur natyrën, nuk mund të programohen masa për mbrojtjen e saj.

I rëndësishëm në këtë proces, përveç vlerësimit të trendit të popullatave sipas specieve është dhe fakti që nëpërmjet sistemit SiMF bëhet i mundur edhe rajonizimi i tyre sipas AdZM-ve në shkallë vendi.

Bazuar në Direktivën e Këshillit të Europës nr. 92/43/EEC e datës 21 maj 1992, mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës e florës së egër (Direktiva e Habitaveve), dhe gjithashtu në Direktivën e Këshillit të Europës nr. 79/409/EEC e datës 2 prill 1979 mbi ruajtjen e shpendëve të egër (Direktiva e Shpendëve), AKZM ka krijuar një Sistem të Monitorimit të Faunës së Egër “AKZM-SiMF”, si sistem kombëtar i monitorimit, i njëjësuar ky me atë të BIONNA-s, si sistem ndërkombëtar i monitorimit. Aktualisht po praktikohet hedhja onlain e të dhënave nëpërmjet aplikimit të këtij sistemi të ri, në mënyrë të përditësuar.

Për vitin 2018, objekt i Vëzhgim-Monitorimit, ishin 40 specie, nga të cilat 10 prej tyre, që erdhën si objekt i shtuar, (për vitin 2017, kishim 30 të tilla), janë shpendë të habitateve ujore kryesisht të liqeneve; Prespë, Pogradec dhe Shkodër. Nga këto 40 specie, 13 janë kafshë dhe 27 prej tyre janë shpendë. Speciet e kafshëve grupohen në gjitarë të mëdhenj, të mesëm dhe gjitarë të vegjël, sikundër shpendët grupohen në ujorë e jo ujorë.

Nga këto 40 specie, 17 prej tyre janë shpallur objekt gjuetie, kurse 23 të tjerat, konsiderohen specie kryesore të faunës së egër, ndaj janë përcaktuar për vëzhgim dhe monitorim.

Speciet objekt i punës, për vitin 2018, rënditen si më poshtë:

- 1 Ariu i Murmë (*Ursus arctos*),
- 2 Mace e Egër (*Felis silvestris*),
3. Rrëqebulli (*Lynx lynx balcanicus*),
- 4 Lundërza (*Lutra lutra*),
- 5 Dhia e Egër (*Rupicapra rupicapra*),
- 6 Kaprolli (*Capreolus capreolus*),
- 7 Baldosa (*Meles meles*)
- 8 Ujku (*Canis lupus*)
- 9 Çakalli (*Canis aureus*),
- 10 Derri i Egër (*Sus scrofa*),
- 11 Lepuri i Egër (*Lepus europaeus*),
- 12 Dhelpra (*Vulpes vulpes*),
- 13 Zardafi/Kunadhja Gushëverdhë (*Martes martes*),
- 14 Shqarthi/Kunadhja Gushëbardhë (*Martes foina*)
- 15 Kryekuqe e Madhe (*Anas penelope*),
- 16 Kryekuqe Qafëgjelbër (*Anas platyrhynchos*),
- 17 Grilla (*Anas crecca*),
- 18 Rosa Bishtëgjelë (*Anas acuta*),
- 19 Rosa e Përhime (*Anas strepera*)
- 20 Sqepluga (*Anas clypeata*),
21. Marsatorja (*Anas querquedula*),
22. Shapka e Ujit (*Gallinago gallinago*),
23. Bajza (*Fulica atra*),
24. Thëllënxa e Malit (*Alectoris graeca*),
25. Pëllumb i Egër (*Columba livia*),
26. Shapka (*Scolopax rusticola*),
27. Turtulli (*Streptopelia turtur*),
28. Shkurta (*Coturnix coturnix*),
29. Laresha (*Alauda arvensis*)
30. Pelikani Kaçurrel (*Pelecanus creopus*).
31. Kryekuqja e Mjeme (*Aythya ferina*)
32. Kryekuqja e Vogël (*Aythya nyroca*)
33. Zhytraku i Madh (*Mergus merganser*)
- 34..Karabullaku Madh (*Phalacrocorax corba*)
35. Karabullaku me Çafkë (*Phalacrocorax aristotelis*)
36. Pelikani Rozë (*Pelecanus onocrotalus*)
37. Çafka e Përhime (*Ardea cinerea*)
38. Karabullaku i Vogël (*Phalacrocorax pygmeus*)
39. Murrçaku (*Netta rufina*)
40. Dallandëshja Faqebardhë e Detit (*Chlidonias hybrida*)

Mënyrat e identifikimit; Kamera kurth, Vrojtim direkt, Jashtëqitje, Gjurmë, Tjetër (Pupla, Qime etj). Përveç këtyre, në tërësinë e të dhënave të Rangers-ave, në bashkëpunim me specialistët e AdZM-së përkatëse, janë plotësuar edhe informacioni për datën, orën, koordinatat në gradë Decimal, pra jo në UTM dhe vendin e identifikimit (zonë e mbrojtur apo jo dhe emri popullor), konfliktet e ndodhura, lloji i dëmit të shkaktuar dhe koha e kryerjes së tij, ngordhjet e konstatuara në F. Egër (koha, shkaku, mënyra e ngordhjes dhe gjinia e mosha për specien e ngordhur), pa përjashtuar këtu shënime apo sqarime të tjera specifike për çdo rast, sipas zonave të mbrojtura ku është kryer Vëzhgim-Monitorimi. Më poshtë po paraqesim për secilën specie, të dhënat për vitin 2018, sipas AdZM – ve dhe mënyrave të identifikimit:

Problematika në AdZM-të

Sektori i menaxhimit gjatë vitit 2017 lidhur me punën e AdZM-ve ka vërejtur se krahas plotësimit të detyrave kanë patur dhe mangësi si:

Pothuaj të gjitha AdZM-të kanë vonesë në plotësimin e formularëve të ndryshimeve kadastrale, po kështu dhe puna që duhej realizuar në bashkëpunim me bashkitë respective për rastet ku ka mbivendosje të sipërfaqeve të parcelave.

AdZM-ja Berat

- Dërgimin e evidencave mujore disa herw jashtw afatit, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi në përshkrimin e informacionit.
- Ka patur vonesa në kohë për dhënien e mendimeve të shkresave të skanuara.

AdZM-ja Fier

- Ka patur vonesa në kohë për dhënien e mendimeve të shkresave të skanuara.
- Sektori menaxhimit nuk u përgjigjet në kohëkërkesave për dhënie mendimi.
- Ka paqartësi në ndjekjen e detyrave që u lihen për zbatim.

AdZM-ja Durrës

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi në përmbajtjen e raporteve, informacioneve.
- Nuk është përgjigjur në kohën e duhur kërkesave të bëra nga sektori i menaxhimit veçanërisht lidhur me dhënien e mendimeve të shkresave të skanuara.

AdZM-ja Lezhë

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi.
- Nuk është përgjigjur në kohën e duhur kërkesave të bëra nga sektori i menaxhimit veçanërisht lidhur me dhënien e mendimeve të shkresave të skanuara.

AdZM-ja Korçë

Krahas punës së mirë janë vrejtur mangësi si:

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi.

AdZM-ja Tiranë

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi në informacione të cilët janë të vakta dhe me përmbajtje jo të rregullt.
- Nuk ka ndjekur në vijimësi problematikat që kanë rezultuar nga subjektet që kryejnë veprimtari të paligjshme në zonat e mbrojtura (Guroret).

AdZM-ja Dibër

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi.

- Nuk ka ndjekur në vijimësi problematikat që kanë rezultuar nga subjektet që kryejnë veprimtari në zonat e mbrojtura (HEC-et dhe minierat).

AdZM-ja Elbasan

- Nuk u është përgjigjur në kohë shkresave të skanuara apo kërkesave për dhënie mendimi.
- Nuk ka ndjekur në vijimësi problematikat që kanë rezultuar nga subjektet që kryejnë veprimtari të paligjshme në zonat e mbrojtura (HEC-et dhe minierat).

AdZM-ja Kukës

- Nuk ka ndjekur sa duhet problematikat që kanë rezultuar me subjektet që kryejnë veprimtari në zonat e mbrojtura (HEC-et dhe minierat).
- Nuk ka dërguar në afat evidencat mujore.

AdZM-ja Gjirokastrë

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi në informacione.
- Nuk ka dërguar në kohë dhënien e mendimeve me shkresat e skanuara.

AdZM-ja Vlorë

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave.
- Nuk ka dërguar në kohë studimet që duhet të realizohen veçanërisht për rastet kur ka rrëzim të pemëve në zonat e mbrojtura, Nuk dërgoi brenda vitit evidencën e kontratave të lidhur në sipërfaqet kullosore.(rasti i pemëve të rrezuar nga tornado në PM Vjosë – Nartë).

Sektori i menaxhimit gjatë vitit 2017, ka kryer e realizuar detyrat e ngarkuara dhe në saj të një bashkëpunimi me sektorin e monitorimit, të projekteve si dhe me Drejtorinë e Financës dhe shërbimeve të brendshme. Po kështu ka bashkëpunuar dhe me institucione të ndryshme shtetore si:

- Me Drejtorinë e Zonave të Mbrojtura dhe Biodiversitetit ku një ndër detyrat e realizuara ka qënë dhe rishikimi i planeve të menaxhimit për parqet natyrore rajonale (PNR) dhe u finalizua me përgatitjen e një Draft – Manuali për parqet natyrore rajonale (Ulëz, Kthellë, Shkrel).
- Drejtorinë e Trajtimit të Pyjeve dhe Kullotave në MM, lidhur me problemet kadastrale.
- ISHMP-në, lidhur me faunën e egër dhe ndjekjen e procedurave për kafshët që ishin në kushte robërie (ariu i murmë).
- AKM-në, lidhur me dhëniet e mendimeve dhe lejet mjedisore të subjekteve të HEC-ve.
- MBZHURU-në për Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, ku kemi qënë pjesëmarrës në të gjitha takimet e organizuara, kërkuar dhe arritëm që AKZM-ja të jetë pjesë e kësaj strategjie. Jemi përfshirë deri në finalizimin dhe miratimin e Draftit final, me ALUIZNI-n (kemi dhënë informacion lidhur me ndërtimet që ndodhen në zonat e mbrojtura, duke përcaktuar qartë zonën e mbrojtur, kategorinë e saj, zonimin e brendshëm dhe bazuar në planin e menaxhimit mbi lejueshmërinë e veprimtarive në këto zona),
- MZHU-në (AKPT e AZHT) për PPV dhe VSM-të e bashkive dhe problem të tjera lidhur me territorin.
- AKB dhe Ministrinë e Kulturës (IMK dhe ASHA) lidhur me PK “Butrint” dhe vijën bregdetare.

Sektori i menaxhimit gjatë vitit 2017 gjithashtu ka ndjekur

- ❖ Punën për përgatitjen e kthimin e përgjigje të shkresave ardhur në adresë të AKZM-së.
- ❖ Specialistët e sektorit janë aktivizuar në punë të përbashkëta dhe me sektorin e monitorimit (gjatë kontrolleve të ushtruara në AdZM-të e qarqeve). Në bashkëpunim me këtë sektor pothuaj në të gjitha kontrollet e kryera krahas monitorimit është bërë dhe kontrolli i zbatimit të urdhërave të dala lidhur me menaxhimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.
- ❖ Sektori i menaxhimit ka ndërtuar një databasë kombëtare për vendodhjen e të gjithë HEC-eve që gjenden brenda rrjetit të zonave të mbrojtura. Në bashkëpunim me AdZM-të e qarqeve u mbodh dhe u grumbullua dokumentacioni teknik që disponojnë subjektet në terren, nga ku u bë dhe klasifikimi i tyre se në çfazë janë ato (ndërtimi apo proces prodhimi). Jemi në përditësimin e këtij databezi, pasi në terren jepen informacione të reja nga AdZM-të. Kjo detyra do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2018, për të saktësuar vendodhjen e tyre sipas koordinatave.
- ❖ Janë shqyrtuar disa Projekte rehabilitimi për HEC-e si ai i Langaricës, Idro Pulitës, Kenxhit dhe Dragobisë dhe kur kanë qënë në përputhje me kërkesat e Planeve të menaxhimit të tyre, janë miratuar.
- ❖ Është përgatitur një tabelë përmbledhëse të identifikimit të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura.

IV . Objektivat për vitin 2018.

- Detyrat kryesore të Sektorit të Menaxhimit për vitin 2018, dalin nga programi “Mbi Strategjinë kombëtare për zonat e mbrojtura” dhe konkretisht do të jenë:
- Puna e sektorit të menaxhimit gjatë këtij viti do të mbështetet në tre shtylla kryesore:
- a. Punë e thelluar dhe argumentuar (për çdo përgjigje apo dhënie mendimi të shprehemi me përmbajtje të thelluar, bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi).
- b. Shpejtësi në kryerjen e veprime.
- c. Saktësi në vendime.
- 1. Organizimi i punës për hartimin, standartizimin dhe mbajtjen e të gjithë të dhënave nëpërmjet përdorimit të teknologjive të avancuara. (Rregjistri Kombëtar), për të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë që do të kryhen dhe trajtohen gjatë vitit 2018.
- 2. Plotësimi i skedave biologjike, sipas unifikimit të modelit të tyre për çdo zonë të mbrojtur.
- 3. Monitorimi i vazhdueshëm i florës dhe faunës së egër në zonat e mbrojtura, krijimi dhe mbajtja e databasës së të dhënave të marra.
- 4. Vazhdimi i punës për saktësimin dhe standartizimin e treguesve kadastral për zonat e mbrojtura në bashpunim me Drejtorinë përkatëse në Ministri (zona e mbrojtur, ekonomia pyjore/kullimore, parcelat e tyre, sipërfaqet, hartat përkatëse).
- 5. Verifikimi mbi kontratat ekzistuese të lidhura nga ish-DRSHP-të, ndjekja e tyre mbi zbatimin e menaxhimin e veprimtarive të lejuara në përshtatje të ligjit të zonave të mbrojtura deri në likuidimet financiare totale. (Kjo detyrë do të kryhet në bashkëpunim me AdZM-të dhe Drejtorinë e Finacës).
- 6. Hartimi i Draft- Kontratave për veprimtari të lejuara në zonat e mbrojtura duke synuar në vjeljen e grumbullimin e prodhimeve të dyta pyjore brenda zonave të mbrojtura.
- 7. Hartimin dhe zhvillimin e planeve të mbarështrimit të pyjeve nga specialistët e AdZM-ve, ndjekja e realizimit të tyre dhe përmirësimi i metodologjisë.
- 8. Hartimin dhe zhvillimin e studimeve për mbarështrimin e kullotave (për kapacitetin mbajtës, gjendjen floristike dhe elementeve të infrastrukturës e kzistuese, rekomandime për përmirësimin e tyre) nga specialistë të AdZM-ve, ndjekja e realizimit të tyre.

- 9. Hartimi i planeve dhe gjetja e metodave për mirëmenaxhimin e zonave turistike, ngritja e grupeve të punës për informimin dhe shoqërimin e turistëve që frekuentojnë këto zona.
- 10. Studimi dhe përmirësimi i disa planeve të menaxhimit, bazuar në objektivat e reja për zonat e mbrojtura dhënë nga Strategjia Kombëtare dhe PPV-të e bashkive të miratuara.
- 12. Hartimi i planeve për ndërhyrjet e nevojshme me përmirësim të infrastrukturës në zonat e mbrojtura, për furnizimin me dru zjarri të familjeve me banim në zonat e mbrojtura.
- 13. Organizimi i punës për gjetjen e burimeve të të ardhurave në zonat e mbrojtura për çdo AdZM, si kontrata për kullotat, bimët mjeksore, prodhime të dyta pyjore e jo pyjore, dhënie në përdorim të sipërfaqeve për ushtrim aktivitetesh etj, (sipas specifikave që ka çdo zonë e mbrojtur).

Spektori i Menaxhimit.